



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR**

Nr 2005 Prot.

Ballsh më 06/11 /2017

VENDIM

Nr. 55 Datë 03/11 /2017

**“PËR RIORGANIZIMIN E NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË
MALLAKASTËR”**

Në bazë të neneve 81 pika 2 shkronja f, pika 83 pika 1 dhe 108 pika 2 të Kushtetutës , Ligjit nr 115/2014 “Për ndarjen administrative – territoriale të Njësive të qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, në bazë të nenit nr 95 pika 1 të Ligjit nr 139 ,datë17.12.2015 “ Për Vetqeverisjen Vendore ” .Deri në datën 31 dhjetor 2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë administrative. Nga 1 janari 2018, këshilli i bashkisë ka kompetencën të vendosë për riorganizimin e administratave të njësive administrative, të cilat mund të mbulojnë territorin e një ose më shumë njësive administrative brenda bashkisë, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative.

VENDOSI :

1. Riorganizimin e Njësive Administrative në Bashkinë Mallakastër .
2. a) Bashkimin e Njësive të mëposhtëshënuara :
 - i. Njësia Administrative Ngracan.
 - ii. Njësia Administrative Aranitas.
 - iii. Njësia Administrative Qendër .
 - iv. Njësia Administrative Greshicë .
 - v. Njësia Administrative Hekal .
- b) Këto Njësi Administrative do të funksionojnë si një e tërë dhe do të administrohen nga administrata e Bashkisë Mallakastër me vendndodhje në Lagjen “ 18 Prilli ” Ballsh në godinën e Bashkisë Mallakastër.
3. Riorganizimi i Njësive Administrative Kutë , Fratar , Selitë në një njësi të vetme me qendër në Damës , Fratar . Emërtimi i njësise do të jetë Njësia Administrative Fratar .
4. Ky riorganizim do të hyjë në fuqi më datë 01/01/2018 .

SEKRETAR

Fatjon NAZERAJ

KRYETAR

Migjen SKENDERAJ

RELACION ARSYETUES PËR RIORGANIZIMIN E NJESIVE ADMINISTRATIVE.

Bashkimi i njesive administrative rreth Bashkisë Mallakastër kryhet për disa arsye. Në këtë relacion ne paraqesim tre pikat më kryesore:

1. Përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve
2. Largësia nga qendra e Bashkisë dhe infrastruktura.
3. Uljen e kostove operative

Bashkimi i njësive administrative Ngraçan, Aranitas, Qendër, Hekal, Greshicë do të bashkohen dhe do të administrohohen nga Bashkia Mallakastër stafi qëndror. Njësitë administrative Selitë, Kutë dhe Fratar do të bashkohen në një njësi të vetme dhe do të administrohen si një njësi e vetme në Fratar.

1 Përmirësimi i Shërbimeve ndaj Qytetarëve- Riorganizimi i Njësive Administrative Ngraçan, Aranitas, Greshicë, Hekal, Qendër në Bashkinë Mallakastër.

Shërbimet të cilat ofrohen nga njesite administrative janë vertetime të ndryshme, si vertetim banimi, vetëm disa njësi ofrojnë vertetime për masën dhe kategorinë e tokës, vertetime për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe plotësimi i dokumentacionit nga ana e qytetarëve të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike si dhe shërbime të gjendjes civile. Gjithashtu një nga shërbimet kryesore të cilat njësitë administrative janë problemet të cilat lidhen me pronësinë.

Kërkesat dhe ankesat më të shumta të qytetarëve nga njësitë administrative janë ato që lidhen me konfliktet e pronësisë. Njësitë administrative nuk kanë personelin e duhur për zgjidhjen e këtyre problemeve. Për të trajtuar një çështje lidhur me pronësinë, kërkohet, agronom, topograf dhe jurist. Punësimi i këtyre punonjësve është i pamundur në të gjitha njësitë pasi nuk mund të gjenden specialist. Në Mallakastër ka mungesë specialistësh të këtyre fushave. Për të zgjidhur problemet e pronësisë por edhe problem të tjera që lidhen me infrastrukturën, shërbimet, mjedisin etj.

Me organizimin e ri ofrimi i shërbimeve do të funksionojë si më poshtë:

Pasi qytetari paraqet kërkesën e tij në sportel duke u paraqitur vetë, me anë të një telefonate ose një mesazhi elektronik, punonjësit e sportelit e dërgojnë ankesën në drejtorinë përkatëse. Paskëta grupet e punës të Bashkisë sipas problematikës së qytetarit do të vihen në lëvizje dhe do të shkojnë

në vendin e kërkuar nga qytetari. Punonjësit e Bashkisë mund ti japin një zgjidhje më të drejt dhe më pak të kontestueshme nga qytetarët, duke u bazuar në kualifikimin e tyre.

Gjatë funksionimit të njësive në dy vitet e fundit anjese administrative kanë dështuar të zgjidhin problemet të cilat janë të lidhura me pronësinë për arsye të mungesës së specialistëve. Këto probleme në pjesën dërrmuese të tyre janë adresuar Bashkisë në zyrat e saj në qytetin e Ballshit ku edhe pjesa dërrmuese e tyre janë trajtuar nga grupet e punës së Bashkisë. Pra stafi i njësive administrative nuk ka arritur të trajtoj problemet që kanë qytetarët, nuk kanë arritur të ofrojnë shërbimet për qytetarët e për rrjedhojë misioni i tyre mund të konsiderohet i dështuar.

- a) **Shërbimet** siç janë Vertetimet e ndryshme, informacione të ndryshme do të jepen nga zyra me “nje ndalese e cila do të instalohet brenda Bashkisë Mallakaster”. Shërbimi ndaj qytetarëve do të afrohet në disa forma. Nëse një qytetar do ti duhet një shërbim si përshembull pajisja me një dokument ai mund të paraqitet fizikisht në sportel jep disa të dhëna sipas rastit, karte identiteti dhe merr dokumentin, përsëri në të njëjtin sportel në një kohë jo më vonë se një orë nga paraqitja në sportel. Një formë tjetër për të kërkuar një dokument është nëpërmjet telefonit. Qytetari telefonon në Bashki, punonjësi merr të dhënat dhe qytetari paraqitet në sportel për të marrë dokumentacionin e kërkuar. Nëse qytetari nuk mund të paraqitet në sportel dokumenti i dërgohet me anë të shërbimit postar në shtëpi. Po kështu për të marrë një dokument qytetari mund të dërgoj një mesazh në nr e telefonit celular, një mesazh në chatshap, viber ose email dhe dokumentacioni mund ti kthehet në të njëjtën formë.
- b) **Ndihma ekonomike** prej janarit të vitit 2018 do të ndryshoj mënyrën e ofrimit të saj. Qytetarët të cilët trajtohen apo kërkojnë të trajtohen me ndihmë ekonomike nuk do të paraqiten te punonjësi i ndihmës ekonomike një herë në muaj ashtu si është aktualisht por ata do të paraqiten një herë në tre muaj. Pra frekuenca e lëvizjes së personave në nevojë do të jetë vetëm 4 herë në vit.
- c) **Shërbimi i gjendjes civile**, do të përqëndrohet në dy qendra në njësinë administrative Fratar dhe në godinën e Bashkisë në qytetin e Ballshit. Shërbimet e gjendjes civile tashmë janë reduktuar. Institucionet janë të detyruar të ofrojnë vetë certifikata për qytetarët. Shërbimi në shumicën e njësive administrative nuk është më i nevojshëm.

Shërbimi i qytetarëve – Riorganizimi i Njësive Selitë, Kutë në Fratar.

Shërbimet në njësinë Fratar do të ofrohen me të njëjtin model si edhe në Bashki. Banorët e njësisë administrative Kutë, të fshatrave Anebreg, Drizar dhe Corrush sipas vendosjes në terren si dhe infrastrukturës rrugore është më e lehtë për ta të shkojnë në njësinë Fratar sesa në njësinë Kutë. Për sa i përket fshatit kute do të ketë një punonjës të punuar në njësinë e re Fratar i cili nëse është e mundur do të jetë banor i këtij fshati i cili do të shërbej si person ndërlidhës midis Njësive Administrative Fratar dhe Fshatit Kute.

Për sa i përket ofrimit të shërbimeve për qytetarët e njësisë administrative Selitë, fshati Kapaj dhe Cerril nuk ndodhen larg nga Njësia Fratar. Qytetarët e Fshatrave gjerbës dhe Selitë mund të marrin shërbimet në njësinë administrative Fratar por edhe në Bashki nëse ata dëshirojnë.

Njësitë Administrative aktuale, Kutë Selitë dhe Fratar I bashkon edhe tradita shekullore e organizimit të pazarit ditët e enjte në Fratar, ku shumica e qytetarëve të këtyre njësive frekuentojnë këto ambjente. Dita e enjte si një ditë pune për administratën mund të shërbejë qytetarëve për të marrë shërbime të ndryshme në njësinë administrative të riorganizuar me qendër në Fratar. Po kështu Njësitë Kutë dhe Selitë janë të lidhura me njësinë Fratar edhe me arsimin. Në Fratar gjendet shkolla e mesme e pergjithshme ku nxenes nga këto njësi frekuentojnë shkollën së bashku. Njësia Administrative Fratar ndodhet pranë Superstartdes Levan – Tepelen, ku qytetarët pasi marrin shërbimin (një dokument) ata lehtësisht mund të udhëtojnë në qytete të tjera ku mund të paraqesin këtë dokument.

2. Largësia nga qendra e Bashkisë dhe infrastruktura.

Njësia administrative Aranitas Fshati Arnitas ndodhet 5 kilometra larg qytetit të Ballshit me rrugë të asfaltuar ku lëvizja kryhet lehtësisht. Fshati Panahor dhe Cucen ndodhen më afër Ballshit sesa njësia administrative aktuale me qendër në Fshatin Aranitas. Pjesa më e madhe e fshatit Cfir lëviz nëpërmjet rrugës Cfir- Ngracan Panahor Ballsh duke shmangur Aranitasin. Për Qytetarët e Fshatit, Cfir Panahor dhe Çuçen ofrimi i shërbimeve në Aranitas nuk është i përshtatshëm.

Njësia administrative Hekal gjendet 7 kilometra nga qyteti i Ballshit me rrugë të asfaltuar. Marrja e shërbimeve më cilësore dhe të shumëllojshme ka kosto minimale për të ardhur në qytetin e Ballshit. Fshatrat Romes dhe Mollaj për shkak të pozicionit të tyre gjeografik e kanë më të lehtë të udhëtojnë për në Ballsh ashtu si edhe aktualisht ata janë duke bërë sesa të udhëtojnë drejt Hekalit. Fshati Koilaç ndodhet më afër qytetit të Ballshit sesa fshatit Hekalit.

Njësia Administrative Greshice ndodhet në rrugë nacionale e cila e lidh me Ballshin. Vendodhja në rrugën nacionale e cila lidh Njësinë Administrative Fratar me Qendrën e Bashkisë në Qytetin e Ballshit rritë mundësinë e lëvizjes së tyre me automjete.

Njësia Administrative Ngraçan ka regjistruar një shumë të vogël shërbimesh, ankesash dhe kërkesash, lidhur kjo edhe me numrin shumë të vogël të popullsisë që jeton aty. I vetmi shërbim ngelet ndihma ekonomike e cila do të ofrohet një herë në tre muaj me hyrjen e ligjit të ri në fuqi për ndihmën ekonomike.

Njësia Administrative Qendër Dukas, si njësia më e madhe administrative aktualisht godina e shërbimeve ndodhet vetëm 700m larg godinës qendrore të Bashkisë në qytetin e Ballshit. Qytetarët të cilët banojnë në fshatra të kësaj njësie duhet të shkojnë në Dukas në njësinë aktuale dhe më pas duhet të ecin në këmbë për të ardhur në qytetin e Ballshit për të marrë shërbime të tjera.

3. Uljen e kostove operative

Rirorganizimi i njësive administrative do të ulë kostot operative, pasi do të reduktohet numri i punonjësve e për rrjedhojë ulja e pagesës për paga dhe sigurime shoqërore, nuk do të ketë kosto për mirëmbajtje dhe bazë materiale, spenzime të energjisë dhe ujit etj, për godinat egzistuese. Për më tepër godinat egzistuese mund të përdoren, për shkollë apo ambulancë, qendra kulturore, nëse është e nevojshme.


Si përfundim një qytetar i njësive administrative ka shumë arsye për të udhëtuar drejt qytetit të Ballshit, për të marrë shërbime më cilësore në Bashki, për të marrë shërbime të tjera që afrohen në qytetin e Ballshit, siç janë, shërbimi arsimor, i energjisë elektrike, ai shëndetsor etj. Pra një qytetar i cili vjen në qytetin e Ballshit mund të kryej të gjitha shërbimet në një ditë.

P/S/Juridik

Specialiste Në Drejt. e Planifikimit

Z/V Kryetar I Bashkisë Mallakastër

Nertil SAKAJ



Besjane VELAJ



Hajredin SERJANAJ

